

Përgjegjës/Sektori i Financës, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 25/24 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783 datë 18.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024 “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, urdhrin të Kryeministrit nr. 239, datë 16.12.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës/Sektori i Financës, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Organizon dhe koordinon veprimtarinë e sektorit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij;
- Përgjegjës për kontrollin e punës lidhur me mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të AKSK, që nga planifikimi korrekt i shpenzimeve operative, investimeve dhe zbatimin e procedurave financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Kontrollon dhe siguron mirëadministrimin e pasurisë së AKSK, për kryerjen në afat të inventarizimit të vlerave monetare dhe materiale;
- Kontrollon veprimtarinë administrative financiare dhe siguron përdorimin efektiv të fondeve të institucionit, përfshi fondin e pagave, si dhe të gjitha transaksionet financiare që lidhen me nevojat e institucionit dhe në marrëdhënie me të tretët;
- Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse në AKSK për hartimin, monitroimin dhe vlerësimin e PBA-së në tregues sasiorë dhe buxhetorë për çdo program buxhetor;
- Monitoron periodikisht zbatimin e buxhetit, në përputhje me standartet dhe procedurat e përcaktuara në ligjin e buxhetit dhe udhëzimet përkatëse, për hartimin dhe zbatimin e buxhetit;
- Përgjegjës për kontrollin e pasqyrave financiare vjetore të përgatitura nga specialistët.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.

Përvoja: Të ketë minimumi 3 vite përvojë pune në profesion.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e aktet nënligjore në zbatim të tyre;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

Aftësi :

- Njohuri të gjëra të politikës, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon drejtoria, njohuri shumë të mira të procedurave administrative, njohuri shumë të mira profesionale, aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritetet dhe respektuar afatet, aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punët e stafit në varësi, aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Të njohë shumë mirë Ligjin Nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e aktet nënligjore në zbatim të tyre;
- Të ketë eksperiencën e nevojshme për të menaxhuar nga pikëpamja financiare dhe procedurale projektet që zhvillohen si brenda vendit, ashtu dhe me organizma të huaja;
- Të njohë mirë gjuhë angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet;
- Të njohë programet kompjuterike bazë.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (III-2)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 26.01.2025, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@aksk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.